



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 068 20 80770
E-mail: bleskaj@klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 21/12/2018

V E N D I M

Nr. 242, Datë 21/12/2018

P Ë R

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
"Cilësia e ujit të pijshëm për konsumatorët"

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 93/2, datë 25.04.2018 realizoi auditimin e performancës me temë "Cilësia e ujit të pijshëm për konsumatorët". Ky auditim u programua për t'u ushtruar konkretisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencinë Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime; Ndërmarrjet e Ujësjetës Kanalizime sh.a. të shpërndara në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë; Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Institutin e Shëndetit Publik si dhe strukturat rajonale të shëndetit publik të shpërndara në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë; Bashkitë në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 93/22, datë 17.09.2018 u dërgua projekt-raporti i auditimit në Agjencinë Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime, Institutin e Shëndetit Publik si dhe në formë elektronike të gjithë ndërmarrjeve të ujësjetës kanalizime, të përfshira në këtë auditim, për të përthithur sa më shumë opinione dhe observacione në drejtim të përmirësimit mëtejshëm të shërbimit të ofruar për konsumatorët, me fokus kryesor "Cilësia e ujit të pijshëm për konsumatorët".

Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysh të dhënat sipas pyetësorëve dhe shpjegimeve të dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raport Auditimit.

Në përfundim, pasi u njoha me Reportin e Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga institucionet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtoria e Standardeve dhe Kontrollit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e

auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10, 13, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

KONKLUDOVA:

Në politikat shoqërore të një vendi, vend të rëndësishëm zë ngritja e një sistemi sa më cilësor të në shërbim të qytetarit.

Uji luan një rol të rëndësishëm për shëndetin dhe kjo lidhet kryesisht me ujin e pijshëm, por gjithashtu në mënyrë jo të drejtpërdrejtë me ujin e përdorur (të mbjellat në bujqësi, bagëtitë, sistemet me ajër të kondicionuar, etj.). Ky rol kthehet në një mekanizëm për ruajtjen e shëndetit kur uji përdoret për qëllime higjienë, e ku kryesisht sasia është faktor përcaktues më i rëndësishëm se sa cilësia. Njohja e këtyre ndërveprimeve lehtëson shpjegimin e marrëdhënies mes shkakut dhe pasojës së ndotjeve, çështjet e menaxhimit të ujit dhe ndikimin mbi shëndetin.

Sot sfida në përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm qëndron në menaxhimin e tij në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në vendimmarrje, duke ofruar përfitime të barabarta, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore të BE-së. Menaxhimi sa më efikas i ujit të pijshëm qëndron në rritjen e transparencës, besimit dhe shmangies së abuzimeve sepse në shumë raste performanca matet vetëm me shifra, por harrojmë se mënyra sesi e menaxhojmë atë reflekton qasjen sociale për brezat e ardhshëm.

Kontrulli i Lartë i Shtetit, në kuadër të objektivave të parashtuara në Planin Strategjik të Zhvillimit 2013-2017 dhe atij 2018-2022, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit (INTOSAI, EUROSAI) dhe praktikave më të mira evropiane, ka ndërmarrë këtë auditim performance dhe dhënien e opinioneve, për përmirësimin, modernizimin e sistemit të menaxhimit të ujit të pijshëm, në ofrimin e tij sa më cilësor me kosto sa më të ulët e për rrjedhojë tarifa të përshtatshme, sepse nuk është plotësisht në harmoni të plotë me kërkesat e konsumatorëve në drejtim të:

- a) rritjes së cilësisë së shërbimit, ulje koston e tarifave, trajtim të barabartë të kërkesave dhe të detyrimeve tyre, rritje të transparencës, etj.;
- b) përmirësimin të infrastrukturës së rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm;
- c) përmirësimin të sistemit të largimit dhe përpunimit të ujërave të përdorura;
- d) furnizimit me ujë 24 orë në ditë;
- e) përmirësimin të cilësisë së ujit të pijshëm sipas standardeve shtetërore dhe të BE;
- f) nga disa përlllogaritje të thjeshta të realizuar nga studiues të ndryshëm në botë, rezultojnë se vetëm nga përdorimi i ujit të çezmës **“A e dini se ?”**

A e dini se?

Mesazhimt, uji me shpejtë konsumon:

2,000 litra me shpejtë konsumon çdo qytetar në ditë.

30,000,000 litra me shpejtë konsumon çdo ditë në tërësi të shtetit.

1 litër ujë me shpejtë konsumon për pijshëm.

3 litra ujë çezmë për ujë të përdorur.

10,000 litra me shpejtë konsumon çdo shtëpi në ditë.

Rëndësia e këtij auditimi ka të bëjë me hartimin e politikave në përmirësimin e shërbimit në interes të konsumatorit për cilësinë e ujit, për tu bërë pjesë e partneritetit publik, duke bërë vlerësimin e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, promovuar eksperiencat efikase, sepse uji nuk është një produkt tregtar si gjithë të tjerët, por në të vërtetë është një trashëgimi e cila duhet të ruhet, mbrohet dhe trajtohet si e tillë.

Auditimi është bazuar në parimin e partneritetit, në përsosjen e akteve ligjore në frymën e bashkëpunimit në shërbim të konsumatorit, qytetarit, taksapaguesit dhe operatorëve ekonomikë. Gjithashtu me anë të këtij auditimi ne kemi vëmë në pah anët pozitive dhe negative të kryerjes së furnizimit me ujë të pijshëm sa më cilësor për konsumatorin, si një përpjekje e angazhim profesional për këtë shërbim sa jetësor.

Qëllimi i auditimit: është përmirësimi i transparencës në mbrojtje të konsumatorit, nëpërmjet bashkëveprimit të gjitha palëve për të nxitur zhvillimin e sektorit ujësjellës-kanalizime, respektimin e standardeve me moton uji është jeta në dorën tuaj.

Objektivi i auditimit: është analizimi me objektivitet i situatës për të rritur përgjegjësitë institucionale që strukturat shtetërore e shoqëritë aksionare kanë në dispozicion, për menaxhim dhe furnizim sa më cilësor me ujë të pijshëm të konsumatorit.

Rëndësia e auditimit: është vlerësimi i performancës në menaxhimin e ujit të pijshëm, në modernizimin e standardeve për një ujë sa më cilësor dhe rritjen e besueshmërisë së konsumatorit për këtë shërbim publik të një rëndësie të veçantë për ruajtjen e shëndetit e njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit.

Mesazhi kryesor i këtij auditimi është: *“Vetitë e ujit i japin formë çdo aspekti të jetës, prandaj Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime, Instituti i Shëndetit Publik, shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve sha., Ministrinë e linjës, pushteti vendor të rrisin bashkëpunim midis tyre edhe me specialistë të fushës, institucionet ligjvënëse e grupet e interesit, që të krijojnë një përfaqje më të mirë besimi, nëpërmjet procesit dinamik të mirë menaxhimit në ofrimin sa më cilësor të ujit të pijshëm, sepse sasia dhe cilësia e ujit në dispozicion të konsumatorit janë faktor të rëndësishëm që përcaktojnë nivelin jetësor të tyre.*

Mangësitë dhe konkluzionet e këtij auditimi janë:

Roli i institucioneve shtetërore qendrore, institucioneve shëndetësore, pushtetit vendor dhe ndërmarrjet e UK sha në rrethet e cilat menaxhojnë dhe monitorojnë infrastrukturën ujore, është që në bashkëpunim të realizojnë veprime ligjore dhe teknike, për furnizimin sa më cilësor me ujë të pijshëm dhe largimit e trajtimit të ujërave të përdorura. Me gjithë punën e bërë deri më sot, në përmirësimin e shërbimit për ofrimin sa më cilësor të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura në minimizimin e mangësive ky shërbim vazhdon të ndeshet me problematikat, që kanë të bëjnë me;

- Legjislacionin dhe mënyrën e përdorimit të tij, përcaktimin e fushës dhe përgjegjësisë;
- kompetencat, vendimmarrjen dhe bashkëpunimin midis institucioneve, mungesën e transparencës dhe ekspertizës në hartimin e strategjive;

- mungesën në furnizimin me ujë të pijshëm;
- furnizimin me orar të reduktuar me ujë të pijshëm ose jo 24 në ditë;
- mungesën e kanalizimeve për largimin e ujërave të përdorur;
- mungesa në monitorimin e cilësisë së ujit;
- ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e tubacioneve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- ndërhyrjet e paligjshme në burimet e ujërave të pijshëm;
- mangësitë në kryerjen cilësore të analizave të ujit të pijshëm;
- mangësi në klorinimin e ujit të pijshëm;
- mangësi në mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- mangësi në mirëmbajtjen e sistemeve të ujërave të përdorura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre;
- eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura të papërpunuara në lumenj, liqene, det, gropa septike;
- mungesën e impianteve të përpunimit të ujërave të përdorura dhe mirëfunksionimin e tyre;
- mungesën e mjeteve dhe të burimeve financiare për furnizimin sa më cilësor me ujë të pijshëm;
- mungesën e mjeteve dhe të burimeve financiare për largimin dhe përpunimin e ujërave të përdorur;
- mangësi në llogaritjen e kostove, dhe përcaktimin e tarifave, për ujin e pijshëm dhe largimin e ujërave të përdorura;
- mangësi në llogaritjen e prodhimit të ujit të pijshëm dhe të humbjeve në rrjet për ujin e pijshëm;
 - mangësive të theksuara në menaxhimin e ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime;
- ndryshimet e shpeshta punonjësve të njësive të menaxhimit të ujit;
- mangësi në trajnimin e aftësimin profesional të punonjësve në përfitimin e përvojave të reja profesionale, duke ndarë dhe përvojën e tyre;
- etj.

Disa nga konkluzionet e auditimit janë;

- Është shumë e rëndësishme kryerja e reformave të vazhdueshme në mirë menaxhimin e sektorit të ujësjellës kanalizime në shërbim të konsumatorëve në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse sepse ofron përfitime social-ekonomike të barabarta dhe për brezat e ardhshëm, sipas parimeve të politikave ujore dhe mjedisore të BE-së. Reformat institucionale kontribuojnë në efikasitetin e ndërmarrjeve ujësjellës-kanalizimeve duke qartësuar çështjet e pronësisë dhe përgjegjësitë e menaxhimit si dhe për më tepër, duke rritur autonominë e tyre krijohet mundësia për rritjen e performancës;
- Mirë menaxhimi i sistemit të ujësjellës kanalizime realizon sa më mirë mundësinë e arritjes qëllimit kryesor të përmirësimit të kohës së shërbimit, nëpërmjet aktivitet ekonomik, i cili synon të përdorë/shpenzojë paratë e taksapaguesve në mënyrë më efektive të mundshme;
- Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i treguesve të performancës, i zbatuar si një proces ciklik e në vazhdimësi, rrit efikasitetin dhe cilësinë e punës së ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizime, për të siguruar shërbime cilësore e të qëndrueshme

financiarisht. Treguesit e performancës, sigurojnë informacionin e nevojshëm kyç, për të përcaktuar efektivitetin e shërbimeve të ofruara;

- Krijimi i një sistemi modern, të qëndrueshëm dhe efektiv të menaxhimit shërbimit të ujësjellës kanalizime duke e harmonizuar me kuadrin ligjor dhe institucional të legjislacionit të BE-së dhe standardet dhe praktikat më të mira ku prioritet dhe objektivat kryesore për zhvillimin janë:
 - ✓ Hartimi i politikave dhe krijimin e mekanizmave efektivë për bashkërendim dhe konsultim;
 - ✓ zhvillimi dhe harmonizimi i mëtejshëm i kuadrit legjislativ me legjislacionin e BE-së dhe praktikat më të mira të BE-së;
 - ✓ forcimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve dhe institucioneve qendrore e lokale;
 - ✓ përmirësimi i kapacitetit operacional dhe elementit funksional të sistemeve;
 - ✓ vendosja e një theksi më të fuqishëm tek arritja e “vlerës për paranë e shpenzuar”.
- Rritja e procesit të ndërgjegjësimit të aktorëve, duke forcuar përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë që prej prodhuesve të ujit, të shoqërive të Ujësjellës-kanalizimeve (UK), e deri tek organet monitoruese e shëndetësore do të shërbejë edhe si një hap drejt forcimit të mekanizmave koordinues midis tyre në këtë proces kompleks, por jetik për konsumatorët, të cilët do të duhet të ndërgjegjësohen për rolin proaktiv që kanë dhe që duhet të ushtrojnë, për të mundësuar ruajtjen e burimeve dhe lehtësimin e ofrimit të ujit cilësisht të pastër;

Nisur nga gjetjet dhe konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë “Cilësia e ujit të pijshëm për konsumatorët”, të ushtruar konkretisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; Agjencinë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime; Ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizime sh.a. të shpërndara në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë; Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Institutin e Shëndetit Publik si dhe strukturat rajonale të shëndetit publik të shpërndara në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë; Bashkitë në 12 qarqet: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

Rekomandimi 1

AKUK në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe UK të mundësojë përmirësimet përkatëse ligjore për rritjen e efijencës të sektorit ujësjellës kanalizime;

Vazhdimisht

Rekomandimi 2

AKUK në bashkëpunim me ERU, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe UK të mundësojë përfundimin plotësisht të procedurave të krijimit kalimit e licencimit të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve në vartësi të njësive të pushtetit vendor në zbatim të reformës administrative – territoriale, sipas procedurave të përcaktuara në Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura";

Brenda vitit 2020

Rekomandimi 3

AKUK dhe UK të rrisin bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe pushtetin vendor, për forcimin e institucioneve të sistemit ujësjellës kanalizime duke orientuar me prioritet investimet në ofrimin sa më cilësor të shërbimit të ujësjellës kanalizime;

Vazhdimisht

Rekomandimi 4

AKUK dhe UK të rrisin bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe pushtetin vendor, për:

- të arritur performancën më të mirë në menaxhimin e sektorit të ujësjellës kanalizime me synim rritjen e cilësisë shërbimit për të mirën e gjithë konsumatorëve;
- të arritur furnizimin 24 orë me ujë të pijshëm sipas standardeve për të gjithë popullsinë e vendit;
- të arritur largimin e trajtimin e ujërave të përdorura sipas standardeve për të gjithë popullsinë e vendit;
- të matur 100 % sasinë e ujit të prodhuar;
- të ulur nivelin e lartë të humbjeve të ujit të pijshëm;
- të mundësuar rritjen e të ardhurave si rezultat i rritjes së volumit të ujit të shitur;
- të kryer investime në përmirësimin e rrjetit ujësjellës kanalizime që janë tejet të amortizuar;
- të përmirësuar raportet e rritjes nivelit të prodhimit krahasuar me rritjen e elementëve kostos;
- të përmirësuar tarifatat e ujit të pijshëm dhe largimit e trajtimit të ujërave të përdorura të cilat kanë ardhur gjithmonë e në rritje;
- të rritur nivelin e arkëtimit të ardhurave dhe vjeljen e debitorëve;
- të mundësuar rritjen e financimit nga ndërmarrjet e UK,
- të rritur efektivitetin e punës nëpërmjet treguesit mesatar të punonjësve për 1000 lidhje të shërbyera;
- të përmirësuar afatet e shqyrtimit dhe realizimit të ankesave të konsumatorëve;
- të përmirësuar nivelin tekniko profesional të punonjësve të sistemit të ujësjellës kanalizime dhe të rrisë numrin e trajnimeve e të trajnuarve të punonjësve të cilët në këtë sistem;
- të forcuar në vazhdimësi procesin e monitorimit për mirë menaxhimin e shërbimeve dhe të investimeve të realizuara;
- të mbikëqyrur performancën e sektorit e të vlerësojnë ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve;

- të studiuar dhe propozuar investime direkt në përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm për konsumatorin;
- të ndjekur, kontrolluar dhe monitoruar projektet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ITUN-ëve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë UK, grandet dhe financimet e huaja, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit;
- të audituar dhe matur performancën e shërbimit të ofruar nga sistemi i ujësjellës – kanalizime në shërbim të klientit dhe në drejtim të cilësisë së ujit të pijshëm e rritjes tij;
- të grumbulluar dhe përpunuar të dhëna për sasinë dhe cilësinë e ujit që ju shpërndahet dhe ju tregtohet nëpërmjet autoboteve konsumatorëve në të gjithë vendin;
- të grumbulluar dhe përpunuar të dhëna mbi numrin e subjekteve private që prodhojnë dhe tregtojnë ujë të pijshëm në vendin tonë;
- të grumbulluar dhe përpunuar të dhëna mbi vend burimet që përdorin subjektet private të cilët prodhojnë dhe tregtojnë ujë të pijshëm për konsumatorët;
- të grumbulluar dhe përpunojnë të dhëna mbi numrin e ankesave dhe realizimin e tyre paraqitur nga konsumatorët për cilësinë e ujit të pijshëm;
- të grumbulluar dhe përpunuar të dhëna mbi numrin e puseve dhe ndikimet sasiore e cilësore që sjell shfrytëzimi i burimeve ujore nga hapja e puseve kolektive apo familjare të pakontrolluara;

Vazhdimisht

Rekomandimi 5

AKUK dhe shoqëritë e Ujësjellës Kanalizime të marrin masa me objektiva konkrete, të matshme në afate kohore me persona dhe struktura konkrete, përcaktuar përgjegjësitë, për përdorim dhe shpërndarjen e ujit në mënyrë të barabartë, përmirësimin e cilësisë ujit të pijshëm dhe kufizimit të shkarkimeve të ujërave të përdorura pa u trajtuar;

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Rekomandimi 6

ISHP, AKUK, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me shoqëritë e Ujësjellës Kanalizime, pushteti vendor të monitorojnë e kontrollojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore për mënjanimin e ndotjeve, në zonat e rreptësisë sanitare rreth shpimeve të shfrytëzimit, të ushtrojnë autoritetin e tyre për mbrojtjen e tyre nga ndotjet masive të mundshme të ndërtimeve të konstatuar gjatë monitorimeve; të kontrollojnë, monitorojnë e ndalojnë depozitimin dhe hedhjen e mbeturinave urbane në shtretërit e lumenjve për ruajtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore.

Vazhdimisht

Rekomandimi 7

Instituti i Shëndetit Publik të rrisë bashkëpunim me strukturat Rajonale të Shëndetit Publik, Ministrisë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, shoqërive të Ujësjellës-kanalizimeve, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, me qëllim që të sigurojnë, ofrimin e furnizimit me ujë cilësor të pastër e

vazhdueshëm për konsumatorët me ushtrimin e kompetencave dhe detyrave që ata kanë, në drejtim të:

- përmirësimit të kërkesave të cilësisë për ujin e pijshëm,
- monitorimit dhe përmirësimit të specifikimeve për analizat e parametrave të ujit të pijshëm;
- përcaktimit të vlerave e parametrave që nuk gjenden në tabelat përkatëse për mbrojtjen e shëndetit publik;
- përshtatjes së metodave analitike të ndryshme, në mënyrë që rezultatet përfundimtare të jenë të së njëjtës shkallë besueshmërie me rezultatet e përfituara me metodat e specifikuar më parë;
- përshtatjes së udhëzimeve teknike për ujin e pijshëm të ambalazhuar.

Vazhdimisht

Rekomandimi 8

Instituti i Shëndetit Publik të realizojë analizimin e situatës, arritjen e konkluzioneve dhe marrjen e masave konkrete me synim përmirësimin e qëndrueshëm të cilësisë ujit pijshëm në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, në drejtim të realizimit të:

- ekspertizave në fushën e ujit dhe sanitetit përmes studimeve shkencore lidhur vlerësimin e rrezikut;
- kërkimeve shkencore në fushën e ujit dhe sanitetit, në lidhje me vlerësimin e rreziqeve mjedisore të dëmshme që lidhen me ujin dhe sanitetin, impakti në shëndet;
- analizimit gjendjes teknike të veprave me karakter sanitar (kaptazhe, depo, linja të jashtme dhe të brendshme të ujësjellësit) dhe gjendjes e sistemit të kanalizimeve;
- studimeve në fushën e higjienës së vendeve të banuara;
- propozimeve në lidhje me përmirësimin e legjislacionit, standardeve dhe normave duke patur parasysh përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së;
- ndihmës dhe kualifikimin të specialistëve të shërbimit të higjienës me anë të trajnimeve në fushën e ujit dhe sanitetit;
- kontrollit të vazhdueshëm situatën higjieno sanitare të ujit të pijshëm në vend nëpërmjet analizës së të dhënave që vijnë nga rrethet, vlerësimin të faktorëve të riskut në lidhje me monitorimin e ujit të pijshëm;
- përgatitjes së informacione shkencore në fushën e ujit dhe sanitetit për dikastere të ndryshme shtetërore qendrore dhe lokale;
- përgatitjes analitike të dokumentacionin nga të gjithë laboratorët për hartimin e raport-analizave dhe informacioneve të tjera;
- matjes së performancës për shërbimit e ofruar nga sistemi i ujësjellës - kanalizime në drejtim të cilësisë së ujit të pijshëm dhe treguesve mbi administrimin e sistemit të monitorimit e menaxhimit të cilësisë së ujit të pijshëm;
- informimin, sensibilizimin dhe shtimit të vëmendjes ndaj problemeve të ujit të pijshëm, të popullatës e konsumatorëve ndaj faktorëve të dëmshëm që lidhen me përdorimin jo të përshtatshëm të ujin e pijshëm, në higjienizimin e puseve kolektive e familjarë, në higjienizimin e depozitave të ujit si familjare dhe kolektive, në mos ndërhyrjen e tyre në mënyrë të paautorizuar në sistemin e ujësjellës kanalizimeve dhe ruajtjes së tyre në shërbim të shëndetit njerëzor dhe të mjedisit për brezat e sotëm e të ardhshëm;

Rekomandimi 9

Shoqëritë e UK në bashkëpunim me pushtetin vendor, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, AKUK të punojnë më shumë për funksionimit normal të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimeve në drejtim të:

- krijimit hartave të reja sipas ndarja e re administrative nëpërmjet hartimit të saktë të rrjetit të tubacioneve dhe teknologjisë së sistemit të ujësjellës kanalizime dhe krijimi/plotësimi i një baze të dhënash teknike të linjave të transmetimit që furnizojnë me ujë konsumatorët;
- krijimit të strukturave përkatëse për zbatimin kuadrit ligjor lidhur në ndërhyrjet rrjetit kanalizimeve të ujërave të përdorura;
- evidentimit dhe eliminimit të ndërhyrjet pa leje në rrjet e subjekteve të ndryshme apo individëve, ndërhyrjeve pa profesionalizëm, lidhjeve jashtë kushteve teknike, pa miratimin e UK;
- kryerjes studimeve dhe investimeve për tu përshtatur me direktivat e BE në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve;
- kryerjes studimeve dhe investimeve për tu përshtatur me direktivat e BE në ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve dhe shkarkimit të ujërave të përdorura
- shtimit numrit punonjësve që merren me mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të përdorura dhe plotësimi me mjete të specializuara për zhblokimin e tyre;

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Rekomandimi 10

Shoqëritë e UK në bashkëpunim me pushtetin vendor, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, AKUK të punojnë më shumë për eliminimin e mangësive të karakterit teknik dhe organizativ të cilat çojnë në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm më cilësor të konsumatorëve në drejtim të:

- shtimit të orareve ditore të furnizimit me ujë të pijshëm deri në arritjen e objektivit të furnizimit me 24-orë/në ditë;
- licencimit të puseve privatë e kolektive të furnizimit me ujë dhe marrjes së masave përkatëse për kontrollin e tyre higjieno sanitar;
- eliminimit të ndërhyrjeve të paligjshme në tubacionet e furnizimit me ujë të pijshëm;
- vendosjes 100% të matësve të ujit të pijshëm për konsumatorët dhe në pikat e hyrjes së zonës;
- monitorimit dhe kontrollit të procesit të dizifektimit të ujit me hipoklorit natriumi nga burimi deri në pikat fundore të zonave duke bërë analizën e klorit mbetës dhe cilësinë e ujit;
- përmirësimit të sistemit të menaxhimit, sigurisë së ujit të pijshëm dhe të planit të kampionimeve;
- monitorimit dhe evidentimit të puseve kolektive apo privatë që shfrytëzohen për prodhimin e ujit për konsum familjar të hapur pa lejen përkatëse;
- marrjes masave konkrete në kryerjen e investimeve për vendosjen e sistemeve automatike të klorinimit të ujit të pijshëm;

- shtimit të investimeve për shoqëritë e UK të cilat nuk kanë laboratorë dhe fuqizimit të atyre ekzistuese me pajisjet bashkëkohore për realizimin e analizave laboratorike për cilësinë e ujit të pijshëm;

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Rekomandimi 11

AKUK në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, dhe Shoqëritë e UK të hartojnë standarde dhe specifikime teknike për kanalizime dhe përdorimin e funksionimin e ITUN-ëve;

Menjëherë

Rekomandimi 12

ISHP në bashkëpunim me institucionet shëndetësore, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet ligjvënëse të punojë më shumë dhe nëse duhet të mundësojë hartimin e plotësimin e legjislacionit për marrjen e përgjegjësive në hartimin e raporteve vjetore të plota me të dhëna:

- nga institucionet shëndetësore dhe ISHP për monitorimin, kontrollin apo mbikëqyrjen e sasisë dhe cilësisë e ujit që ju tregtohet nëpërmjet autoboteve konsumatorëve në të gjithë vendin;
- nga institucionet shëndetësore dhe ISHP mbi numrin e subjekteve privatë që prodhojnë dhe tregtojnë ujë të pijshëm në vendin tonë dhe mbi vend burimet që përdorin subjektet privatë të cilët prodhojnë dhe tregtojnë ujë të pijshëm për konsumatorët, efektet e tyre;
- nga institucionet shëndetësore dhe ISHP mbi monitorimin e vendit të derdhjes së ujërave të përdorura të çdo qyteti apo fshati;
- nga institucionet shëndetësore dhe ISHP mbi monitorimin dhe verifikimin e ankesave të paraqitura nga konsumatorët për cilësinë dhe ndotjen e ujit të pijshëm në UK apo në institucionet e tyre;
- nga institucionet shëndetësore dhe ISHP mbi monitorimin apo kontrollin e kryerjes procesin dezinfektimit të kaptazhe, rezervuarë, tubacione shpërndarës, etj., si masë parandaluese për të evituar ndotjen e mundshme të ujit të pijshëm;
- nga ISHP mbi monitorimin apo kontrollin e laboratorëve mikrobiologjik/biokimik që kryejnë analiza për cilësinë e ujit të pijshëm;
- nga ISHP si detyrim ligjor, mos zbatim i kërkesave ligjore dhe marrja e masave administrative në funksion të ruajtjes së cilësisë së ujit për konsumatorët, për tu përfshirë në raportin përfundimtar vjetor mbi cilësinë e ujit që i raportohet institucioneve qendrore;
- nga institucionet shëndetësore dhe ISHP mbi monitorimin apo kontrollin mbi llojin, sasinë, cilësinë e elementëve të përdorur për përmirësimin e vlerave e parametrave ujit të pijshëm apo të mangësive të elementëve të përdorur për përmirësimin e parametrave të ujit të pijshëm si dhe të elementëve për kryerjen e analizave laboratorike për cilësinë e tij në funksion të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve;

- të plota dhe të sakta mbi analizat e kryera për cilësinë e ujit të pijshëm nga shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve dhe drejtorive të shëndetit publik në rrethe të cilat kryejnë analizat e ujit të pijshëm;
- nga institucionet shëndetësore dhe ISHP, nëse realizohet nga administratorët procesi i kryerjes dezinfektimit të rezervuarëve në godinat publike e private shumë katesh, si masë parandaluese për të evituar ndotjen e mundshme të ujit të pijshëm; të cilat informojnë institucionet qendrore, lokale e konsumatorët mbi cilësinë e ujit të pijshëm dhe masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e tij.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Rekomandimi 13

ISHP në bashkëpunim me institucionet shëndetësore, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet ligjvënëse të mundësojë hartimin e plotësimin e legjislacionit në krijimin e kushteve të përshtatshme ligjore, teknike, organizative, për të mundësuar matjen e efektshmërisë nga përdorimi i ujit jo cilësor në shëndetin e njeriut sipas sëmundjeve të diagnostikuara dhe numrit të konsumatorëve të prekur.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Rekomandimi 14

AKUK dhe ISHP në bashkëpunim me shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizime dhe institucionet shëndetësore të sensibilizojnë konsumatorët për realizimin sa më të mirë të procesit kryerjes dezinfektimit të rezervuarëve në godinat publike e private shumë katesh, si masë parandaluese për të evituar ndotjen e mundshme të ujit të pijshëm në to sepse mbrojnë shëndetin e tyre të fëmijëve dhe brezave që vijnë.

Vazhdimisht

Rekomandimi 15

AKUK dhe ISHP në bashkëpunim me shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizime dhe institucionet shëndetësore të realizojnë pyetësorë për mbarëvajtjen e punës së tyre në menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e furnizimit sasior dhe cilësor me ujë të pijshëm konsumatorëve.

Vazhdimisht

Në përputhje me nenin 30 të Ligjit 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Grupi i Auditimit

Rinald Muça

Alfred Zylfi

Elfrida Agolli

Bujar LESKAJ

KRYETAR

